

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.M. nga fshati D. e E. Komuna e P., për shkak se në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzave: PP.nr.33/13 dt.27.02.2013, PP.nr.6471/15 e dt.13.11.2015, PP.nr.5887/12 e dt.04.12.2015, PP.nr.7180/15 e dt.25.01.2016, PP.nr.7193/15 e dt.22.01.2016, PP.nr.5888/15 dt.06.11.2015, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 29.06.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Bashkim Zeqaj dhe të akuzuarit, me datë 01.07.2016, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 12.07.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

F. M., nga i ati A. dhe nëna H., e gjinisë M., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin D. e E. Komuna e P., ku edhe jeton, me nr. personal: *numër personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike-rast social, baba i shtatë (7) fëmijëve, nuk ka qenë më parë i gjykuar, ndaj tij zhvillohet edhe procedurë tjetër për vepra të njëjtë penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e:

Me datën 28.11.2012, rreth orës 15:40, me qëllim të vjedhjes, në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës, zyra në P., në vendin e quajtur “Poillë, Regjioni Ekonomiko-Pyjor ”D.”, Komuna P., ka prerë dhe marrë 185 copë trungje, dru të llojit bung dhe shkozë, me gjatësi 5-9 m, diametër 10-12 cm, dhe me vëllim të përgjithshëm 2.17m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës-zyra në P., i ka shkaktuar dëm material.

Më datë 20.09.2015, rreth orës 12:40, në vendin e quajtur “Kodra e Staneve” në Regjionin Ekonomiko Pyjor të D., KK P., në pyllin në pronësi publike me të cilin menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, është zënë nga roja e pyllit, në pyllin në pronësi publike duke prerë dru zjarri dhe atë trungje të llojit bingu, me diametër 12-13cm, me gjatësi 6 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 3.88 cm³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural-Komuna P., i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 26.09.2015, rreth orës 12:25, me qëllim për të vjedhur ka shkuar në pyll në vendin e quajtur “Poillë”, në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të D., Komuna P., me të cilin menaxhon Komuna P.-Drejtor ati i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Pylltarisë, ku aty ka prerë 427 copë trungje të llojit bingu me diametër 10-12 cm, me gjatësi prej 6m, me

vëllim të përgjithshëm 3,76m³, me ç`rast të dëmtuarës Komunës së P., sektorit të pylltarisë i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 15.10.2015, rreth orës 12:40, me qëllim të vjedhjes, në pyllin me të cilin qeverisë Agjencia Pyjore e Kosovës, në vendin quajtur “Kodra e Staneve” në Regjionin Ekonomiko – Pyjor të D., K. P., ka prerë 286 copë trungje të llojit bingu, të gjata 6m, me diametër 10-14cm, dhe me vëllim prej 2.77m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në P., i ka shkaktuar dëm material.

Me dt.17.10.2015, rreth orës 16:10, me qëllim të vjedhjes në pyll, me të cilin qeverisë Regjioni Ekonomiko-Pyjor i D., në vendin e quajtur “Kodra e Staneve” i pandehuri ka prerë 285 copë dru të llojit bung-shkozë, me gjatësi 6m, me diametër 12-14cm, me vëllim të përgjithshëm prej 3.20m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal në P., i ka shkaktuar dëm material.

Me datën 05.11.2015, rreth orës 12:40, me qëllim të vjedhjes, në pyllin me të cilin qeverisë Autoritetit Pyjor Komunal i K. së P., në vendin e quajtur “Poillë”, në Regjionin Ekonomiko-Pyjor të D., -K. P., është zënë duke prerë 235 copë trungje, të llojit shkozë, të gjata 6m, me diametër 10-12cm, dhe me vëllim prej 2.35m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor Komunal -Komuna P., i ka shkaktuar dëm material.

Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,49,50,51,52,73, nenit 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPPRK-së, e

G J Y K O N

Të akuzuarin F. (A.) M., me dënim me kusht ashtu që shqipton dënim me burg në kohëzgjatje **prej 6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet brenda 1 (një) viti, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **300 € (treqind euro)**, të cilën obligohet ta paguaj brenda afatit prej 1(një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin brenda afatit prej 1 (një) muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t`ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20€ (njëzetë euro), të papaguara do t`i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Konform nenit 453 par.4 të KPPRK-së, gjykata e liron të akuzuarin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit-familjes së tij, pasi që është përfitues i ndihmës sociale.

E dëmtuara Agjensioni Pyjor i Kosovës zyra në P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë- tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit Aktakuzat: PP.nr.33/13 dt.27.02.2013, PP.nr.6471/15 e dt.13.11.2015, PP.nr.5887/12 e dt.04.12.2015, PP.nr.7180/15 e dt.25.01.2016, PP.nr.7193/15 e dt.22.01.2016, PP.nr.5888/15 e dt.06.11.2015, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, kundër të akuzuarit F. M. nga fshati D. e E. Komuna e P., për shkak të veprave penale vjedhja e pyllit nga neni 285 par. 2 dhe 1 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Lidhur me këto çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 30.06.2016 në praninë e Prokurorit të Shtetit Bashkim Zeqaj, të akuzuarit F. M. dhe dëshmitarit K. H..

Gjykata paraprakisht ka verifikuar të kaluarën kriminale për të akuzuarin e lartcekur dhe duke pasur parasysh parimin e ekonomizimit dhe të efikasitetit të procedurës penale, me pajtimin e palëve respektivisht të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit, bazuar në nenin 35 par.8 të KPPRK-së, në shqyrtim fillestar mori aktvendim që të bashkohet procedura penale dhe të zbatohet procedurë unike kundër të akuzuarit F. M. për lëndët: P.nr.248/13, P.nr.1056/15, P.nr.1095/15 ,P.nr.1223/15, P.nr.80/16, P.nr.97/16, ashtu që çështja penale për gjithsejtë 6 (gjashtë) lëndë do të bartë numrin më të vjetër **P.nr.248/13**.

Pas leximit të aktakuzave nga Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor i akuzuari u deklarua i pa fajshëm për veprat penale për të cilat akuzohet.

Prokurori shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Nga shqyrtimi gjyqësor pa mëdyshje u vërtetua plotësisht se i akuzuari ka kryer veprat penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzave dhe kërkoi nga gjykata që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit si dhe ta obligoj ti paguaj shpenzimet e procedurës penale.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi, Nuk është e vërtetë se kam pre dru në pronën publike, nga se unë punoj punëtor fizikë për S.M. i cili e ka malin e vetë dhe vetëm i paloj drutë nuk prej me motor për shkak se nuk jam i aftë sepse e kamë gishtin e dorës të lënduar, jam rast social, roja e pyllit e ka shitur malin dhe më ka shkruar fletëparaqitje për shkak se nuk kamë pasur të holla për ti dhënë dhe kërkoi nga gjykata ta shpallë të pafajshëm dhe ta liroj nga këto aktakuza.

Gjykata gjatë procedurës se provave ka dëgjuar dëshmitarin-roja e pyllit K. H. dhe janë lexuar fletëparaqitjet e rojës së pyllit, të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi gjendjen faktike për veprën penale për të cilën i akuzuari u shpall fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga dëshmia e dëshmitarit-rojës së pyllit K. H., u vërtetua gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i cili veç tjerash deklaroi: Se për të gjitha rastet e ka takuar të akuzuarin duke

prerë dru në pronë publike, që ka qenë me traktor IMT 533, ram dhe sharrë motorike, i cili ka qenë zakonisht me djemtë G. dhe A., e që për të gjitha rastet ka mbajtur ditar të punës.

Nga fletëparaqitjet e rojës së pyllit dhe ditari i punës u vërtetua gjendja faktike me data, kohë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plot dëshmitarit-rojës së pyllit K. H., fletëparaqitjeve, si dhe ditarit të punës, i cili dëshmitar në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar bindshëm se e ka hasur të akuzuarin duke prerë dru në mënyrë të kundërligjshme në pronën publike për secilin rast si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e të cilat dëshmi ndërlidhen njëra me tjetrën, se i akuzuari vërtet ka kryer veprën penale.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, ka konstatuar se i akuzuari në vazhdimësi ka kryer veprat penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së, pasi që e dëmtuara është e njëjtë, objekti i veprës penale i njëjtë si dhe dashja e kryerësit të veprës penale, të parapara me nenin 81 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 të KPRK-së.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 2 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata e ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit duke gjetur se është e drejtuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat u vërtetua përtej çdo dyshimi gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari i ka kryer veprat penale me dashje, me paramendim, sepse kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e tij dhe e ka dashur kryerjen e veprës penale.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se ishte korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor, i gjendjes së vështirë ekonomike, i pa gjykuar më parë, e duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjeti shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që është prona publike, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjkata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave, të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi për lirim nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale është marr duke u bazuar në nenin nenit 453 par.4 të KPPRK-së, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe familjes së tij, pasi që i akuzuari është përfitues i ndihmës sociale bazuar në Kartelën e Ndihmës Sociale me nr..... të datës 21.12.2014.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, për shkak se gjykata nuk ka pasur ekspertizë nga ndonjë institucion i pavarur, në mënyrë që gjykata të vërtetojë saktësisht dëmin e shkaktuar, ashtu që dëmi i vlerësuar vetëm nga pala e dëmtuar nuk parqet bazë të sigurt për gjykim, andaj gjykata nuk e pranoj dhe mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.248/2013,dt.12.07.2016

Sekretarja Juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrajnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.